

Thirrje për ekspert/e monitorimi

Periudha: Mars-Gusht 2020

Ditë pune: 25 ditë

Pagesa: 2500 Euro

Vendi: Tiranë

Afati i fundit për aplikim: 1 Mars 2020

Historia Ime ka hapur thirrjen për Ekspert Monitorimi të mediave online në projektin “Gazetaria Etike në Shqipëri”.

Personi i përzgjedhur do të punojë ngushtë me Asistentin e Projektit dhe do të raportojë tek Drejtuesi Ekzekutiv mbi procesin e monitorimit, vështirësitë dhe sfidat që mund të hasen gjatë periudhës së monitorimit dhe do konsultojë me ta gjetjet e produktit përfundimtar.

Eksperti i Monitorimit është përgjegjës për hartimin e formateve të monitorimit, trajnimin e grupit të punës, koordinimin, dhe evaluimin e Monitorimit. Ai/ Ajo do të zhvillojë një sistem monitorimi dhe evaluimi që të përdoret në vazhdimësi nga organizata jonë.

Detyrat kryesore:

- Të rishikojë dhe përmirësojë formatet ekzistuese të monitorimit dhe mbledhjes së të dhënave për monitorimin “Gjuha e Urrejtjes dhe Diskriminuese në Median Online”
- Të trajnojë grupin monitorues dhe të koordinojë punën.
- Të interpretojë të dhënat e mbledhura nga grupi i punës dhe të hartojë një raport final përmblendës me të dhëna sasiore dhe cilësore.

Produktet finale të punës:

- Formatet e përditësuara të monitorimit
- Formatet e përditësuara të raportimit individual nga grupi i monitoruesve
- 1 trajnim për grupin e punës (3-6 persona)
- Analizimi i të dhënave të mbledhura nga monitoruesit në një raport final, të ndarë në dy pjesë (një për median online dhe një për televizionet.)

Kandidati duhet:

- Të ketë përfunduar studimet e larta në nivelin Master në Shkenca Sociale, Gazetari, Komunikim, apo fusha të ngjashme.

- Të ketë të paktën një eksperiencë të mëparshme si ekspert/e monitorimi mundësisht në fusha të gazetarisë dhe/ose të drejtave të njeriut
- Të ketë përvojë të mëparshme në dizajnimin, zbatimin dhe operimin e sistemeve të Monitorimit dhe Evaluimit
- Të ketë njohuri të metodologjive kryesore të vlerësimit (metoda cilësore, sasore, e përzier) dhe mbledhja e të dhënave
- Të ketë aftësi të mira raportuese dhe sintetizuese
- Të ketë njohuri bazike të gjuhës angleze.

Çfarë është Monitorimi i Gjuhës së Urrejtjes dhe Gjuhës Diskriminuese?

Historia Ime, publikon çdo vit gjetjet e monitorimit të gjuhës së urrejtjes dhe/ose gjuhës diskriminuese në median shqiptare online dhe atë vizive. Monitorimi është realizuar për pesë vite rresht dhe ka për qëllim evidentimin e problematikës së gjuhës së urrejtjes dhe gjuhës diskriminuese e seksiste nga redaksitë e mediave online në këta tregues kryesorë:

Format me të cilat shprehet gjuha e urrejtjes/diskriminuese

Temat e artikujve të cilët kanë më shumë përmbajtje diskriminuese/urrejtje

Të dhëna specifike mbi grupet apo individët më të prekur nga gjuha e urrejtjes/ diskriminuese si gjinia dhe grup mosha

Si të aplikoni:

Dokumentat e mëposhtme duhet të dorëzohen me postë ose dorazi në adresën: Pro-LGBT, Rruga Mine Peza 208, 2/13 Tiranë.

- CV
- Shembuj të punëve të mëparshme përbëjnë prioritet

Afati i fundit i dërgimit të aplikimeve: 1 Mars 2020.

Për më tepër informacion apo paqartësi mund të na shkruani në adresën:
historiaime.com@gmail.com.